

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtaret: Rasim Rasimi kryetari i kolegjit, Gani Zabeli dhe Biljana Rexhiq anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Hysni Ismaili, në çështjen penale kundër të akuzuarve: R.,B., dhe F.H. të gjithë nga fshati ..., Komuna e... për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje, nga neni 188 par. 1 nën par. 4 lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK); G.J. nga ..., rruga "...", pa nr., për shkak të veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 nën par. 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së lidhur me nenin 12 par. 4 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), dhe H.I. nga fshati ..., Komuna e ... për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan dhe ankesës së të akuzuarit G.J., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, P.nr.385/2013, datë 21.12.2015, në seancën e kolegjit të mbajtur, më datë 29.11.2016, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Me rastin e ankesës së të akuzuarit G.J., e sipas detyrës zyrtare, aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan – Dega në Viti, P.nr.385/2013, datë 21.12.2015, ndryshohet vetëm përkitazi me kohën e verifikimit të dënimit, ashtu që Gjykata e Apelit të akuzuarve G.J., R.,B., dhe F.H. për veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor e për të cilat secilit veç e veç iu është shqiptuar dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, dënimin e shqiptuar ia kushtëzon në afat prej 1 (një) viti, me kusht që të akuzuarit brenda kësaj periudhe nuk do të kryejnë veprë tjetër penale.

Ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjilan refuzohet si e pabazuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Gjilan – Dega në Viti, me aktgjykimin P.nr.385/2013, datë 21.12.2015 në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të akuzuarit R.,B., dhe F.H. i ka shpallur fajtor për shkak se në bashkëkryerje kanë kryer veprën penale lëndim i lehtë trupor, nga neni 188 par. 1 nën par. 4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa të akuzuarin G.J. e ka shpall fajtor për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 nën par. 1.1, 1.2 dhe 1.3 si dhe lidhur me nenin 12 par. 4 të KPRK-së, dhe i ka gjykuar secilin veç e veç me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga

90 (nëntëdhjetë) ditë, dënimet e shqiptuara nuk do të ekzekutohen me kusht që brenda 18 (tetëmbëdhjetë) muajve, të mos kryejnë vepra tjera penale. Janë obliguar që secili veç e veç t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale në shumë prej nga 30 €, në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore juridike, janë udhëzuar në kontest të rregullt civil. Në pikën II të dispozitivit të aktgjykimit të akuzuarin H.I. për veprën penale pjesëmarrje në rrahje nga neni 190 par. 1 të KPRK-së, konform nenit 364 par. 1 pika 1.3 të KPPK-së, e ka liruar nga akuza me arsyetim se nuk është provuar se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë kanë paraqitur:

- Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjiilan, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit ankesën ta aprovoj si të bazuar, aktgjykimin e ankimuar ta anuloj në tërësi dhe lëndën t'ia kthej të njëjtës gjykatë në rigjykim.

- I akuzuari G.J., për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe shkeljes së ligjit penale, me propozim që Gjykata e Apelit në Prishtinë aktgjykimin e ankimuar ta ndryshoj dhe të akuzuarin ta liroj nga akuza.

Prokurori i Apelit me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.838/2016 të datës 22.06.2016, ka propozuar që ankesa e Prokurorit të Prokurorisë Themelore në Gjiilan të aprovohet si e bazuar, aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim, kurse ankesa e të akuzuarit G.J. të refuzohet si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në pajtim me dispozitat e nenit 394 të KPPK-së, dhe pasi vlerësoj pretendimet e cekura në ankesa, gjeti se:

Ankesa e Prokurori dhe ajo e të akuzuarit G.J. janë të pabazuara, kurse gjykata sipas detyrës zyrtare ndryshoj aktgjykimin në pjesën gjykuese vetëm sa i përket kohës së verifikimit të dënimit.

Prokurori me ankesë pretendon se aktgjykimi i ankimuar në pjesën ndëshkuese dhe atë liruse përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 383 par. 1 nën par. 1.1 lidhur me nenin 384 par. 1 nën par. 1.12 të KPPK-së, sepse dispozitivit është në kundërshtim me arsyetimin, ndërsa ajo që thuhet në arsyetim të aktgjykimit lidhur me faktet vendimtare është në kundërshtim me përmbajtjen e provave dhe të shkresave të lëndës. Në dispozitivin nën II gjykata të pandehurin H.I. e liron nga akuza për veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 190 par. 1 të KPRK-së, me arsyetim se nuk është provuar se ky ka kryer këtë vepër penale që i vihet në barrë me akuzë, me pretendim se gjykata nuk ka pasur të drejtë që pa vërtetuar atë në mënyrë të gjithanshëm dhe të plotë ta liroj nga akuza.

Gjykata e Apelit gjen se pretendimet ankimore të Prokurorit me ankesë se aktgjykimi i ankimuar është i përfshirë me shkelje të theksuara më lartë nuk janë të bazuara, ngase aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurë penale, e as shkelje tjera të cila kjo gjykatë i shqyrton sipas detyrës zyrtare, e të cilat kishin me kushtëzuar anulimin e aktgjykimit. Dispozitivi i aktgjykimit të ankimuar për pjesën gjyquese dhe atë liruese, është i qartë, konkret dhe nuk përmban kundërthënie me vet veten e as me arsyetimin e tij. Në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar janë dhënë arsye të mjaftueshme faktike dhe juridike, duke vënë në dukje se cilat fakte dhe për çfarë arsye i merr si të provuara apo si të pa provuara, ka bërë vlerësimin e provave kontradiktore konform dispozitës së nenit 370 par. 7 të KPPK-së, duke bërë vlerësimin dhe analizën e të gjitha provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, duke i paraqitur lidhur me këto përfundimet e veta të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë. Në rastin konkret gjykata e shkallës së parë përkitazi me faktet vendimtare bënë edhe vlerësimin e mbrojtësit të akuzuarit G.J., deklarata e tij ka qenë objekt vlerësimi nga gjykata e shkallës së parë, ajo është vlerësuar si çdo provë tjetër në pajtim me dispozitat ligjore, se a do të miratohet deklarata e të akuzuarit, se veprën penale e ka kryer në mbrojtje të nevojshme dhe se a duhet liruar nga akuza, varet nga rezultati i shqyrtimit dhe vlerësimit të tërësishëm të provave të administruara, ku lidhur me këto gjykata e shkallës së parë ka paraqitur konkludimet e veta, të cilat si të drejta dhe të ligjshme i aprovon edhe kjo gjykatë, kurse për pjesën liruese gjykata ka vepruar konform dispozitës së nenit 370 par. 10 të KPPK-së, e cila ka paraqitur arsyet për lirim nga akuzat të pandehurit H.I. ashtu siç është paraparë me nenin 364 të KPPK-së, konkludim këtë të cilin e mbështet edhe kjo gjykatë.

Përkitazi me bazën ankimore vërtetim i gabuar dhe jo i plotë i gjendjes faktike Prokurori me ankesën e tij i referohet aktgjykimit – dispozitivit të tij ku bëhet fjalë për lirim e të akuzuarit H.I. për shkak të veprës penale pjesëmarrje në rrahje, nga neni 190 par. 1 të KPRK-së, me arsyetim se nuk është provuar se ka kryer veprën penale e cila i vihet në barrë me aktakuzë, sepse nuk është provuar nga deklarata e dëshmitarëve të dëmtuarit e as nga provat materiale të shtjelluara. Me ankesë Prokurori konteston këtë konkludim të gjykatës, me pretendim se nuk e din pse gjykata merr si vendimtare mohimin e kryerjes së veprës penale nga i akuzuari, për ta liruar nga përgjegjësia penale për veprën e kryer, sepse ky mohim është i vetëm dhe i pa mbështetur me asnjë provë të vetme dhe se dëshmitarët e propozuar e të dëgjuar në shqyrtimin gjyqësor i kanë ndërruar deklarata e tyre të dhëna në polici, kurse gjykata nuk ka bërë pyetje se pse tani po i ndërroni deklaratat dhe se gjykata është dashur që si të vërtet ta merr deklaratën e këtyre dëshmitarëve të dhënë në polici, prandaj për këto arsye aktgjykimi në këto pjesë duhet të anulohet.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore të Prokurorit sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit për këtë bazë ankimore nuk qëndrojnë. Gjykata e shkallës së parë jo vetëm që drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen e fakteve, faktet për ecurinë si është zhvilluar ngjarje kritike, se nuk ka lënë kurrfarë dilema e dubioza por drejtë dhe ligjshëm ka bërë mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor dhe vlerësimin e provave, pra në bazë të këtyre provave ka nxjerrë konkluzione të drejta dhe të ligjshme se i akuzuari nuk është kryerës i veprës penale pjesëmarrës në rrahje, nga neni 190 par. 1 të KPRK-së. Nuk është kontestuese se i akuzuari H.I. në ditë dhe

momentin kritik ka qenë në shoqëri me të akuzuarin G.J. dhe në momentin e rrahjes në mes tij dhe të akuzuarve B., R. e F. H. siç përshkruhet në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, por të gjithë dëshmitarët e dëgjuar dhe vet të akuzuarit në shqyrtimin gjyqësor nuk kanë pohuar – deklaruar të mos e kenë parë, këtë të akuzuar se ka marrë pjesë në rrahje (gjykata aktgjykimin e vet e mbështet në provat dhe deklaratat e dhëna në shqyrtimin gjyqësor, nëse këto deklarata ndryshojnë prej atyre të dhëna në fazën e hetimeve apo në polici, për këtë dallim në mes tyre gjithsesi përkujdeset Prokurori i çështjes), gjyqtari në shqyrtimin gjyqësor e ka pyetur të akuzuarin - dëshmitarin B. lidhur me ndryshimin në mes deklaratës së dhënë në polici dhe asaj të theksuar në shqyrtimin gjyqësor, i njëjti është deklaruar se dorën ma ka thyer i akuzuari G. e jo siç kam deklaruar në polici se dorën ma ka thyer H., deklaratë kjo e dhënë kur isha nën ndikimin e narkozës, edhe dëshmitari F. është deklaruar se H. nuk ka marrë pjesë në përlëshje, kurse dëshmitari Sh.S. në dëshminë e tij thekson se H. vetëm se i ka ndarë të akuzuarit tjerë.

Të gjitha këto prova të administruara nuk qojnë në konkludim se i akuzuari H. është kryerës i veprës penale, pra nuk japin bazë të mjaftueshme që i akuzuari të shpallet fajtorë, sepse në shkresat e çështjes nuk ka asnjë provë e cilat do ta vërtetonte një gjë të tillë, ndërsa nga ana tjetër as Prokurori në këtë drejtin nuk ofron ndonjë provë konkrete, e cila në mënyrë të sigurt do ta vërtetonte fajësinë e të akuzuarit H., prandaj gjykata e shkallës së parë, drejtë konkludon se në veprimet e të akuzuarit nuk sajohen elementet e veprës penale për të cilën ka qenë i akuzuar. Nga rrethanat e cekura më lartë dhe ato të theksuar në aktgjykimin e ankuimuar dalin si të pabazuara pretendimet nga ankesa e Prokurorit.

Vlerësimi i kësaj gjykate përkritazi me pjesën gjyqësive të aktgjykimit të kundërshtuar.

Duke vlerësuar aktgjykimin e kundërshtuar në pjesën gjyqësive, kjo gjykatë konstaton se sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale është folur më lartë dhe nuk ka nevojë që të përsëriten.

Pretendimet ankimore të akuzuarit G.J. për pjesën gjyqësive të aktgjykimit, me të cilën i akuzuari është shpall fajtorë se ka kryer veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 189 par. 1 nën par. 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së lidhur me nenin 12 par. 4 të KPRK-së. Me ankesë i akuzuari konteston mënyrën se si janë vlerësuar provat e administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe konkludimin e nxjerra të gjykatës së parë në bazë të këtyre provave, pretendon se nga provat e administruara nuk mund të konkludohet se është kryerës i veprës penale, e këtë e vërteton në dëshminë e tij dëshmitari okular Sh.S., duke theksuar se nga të gjitha provat është vërtetuar se ka qenë i sulmuar dhe se për ta mbrojtur jetën në vetë mbrojtje ka reaguar, pra thekson se me shufrën të cilën më kanë sulmuar kam arritur që të mbrohem, me pretendim se kjo nuk është tejkallim i mbrojtjes së nevojshme, kur në ditën kritike të tre të akuzuarit me dashje të përgatitur paraprakisht me shufra metalike kanë dalur dhe e kanë sulmuar duke i shkaktuar lëndim të lehtë trupor dhe se gjatë këtij sulmi iu është shkaktuar lëndimi të akuzuarit B.H., i akuzuari thekson se gjykata aktgjykimin e saj e bazon vetëm në deklaratat e të akuzuarve R.,B., dhe F.H., e që kanë pasur për pasoj edhe konkludimet e gabuara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, duke pretenduar se

ekzistojnë elemente që përjashtojnë përgjegjësinë penale në këtë çështje juridiko penale e që është dashur të lirohet nga akuzua për veprën penale e cila i vihet në barrë.

Gjykata e Apelit vlerëson se pretendimet e mësipërme ankimore nuk qëndrojnë, gjykata e shkallës së parë jo vetëm që drejtë dhe në mënyrë të plotë ka vërtetuar gjendjen e fakteve, dhe se me ankesë nuk vihet në dyshim kjo gjendje e vërtetuar faktike, atëherë gjendja e fakteve e vërtetuara dhe e përshkruar në aktgjykimin e ankimuar mbështete edhe nga kjo gjykatë, ku nga shkresat e lëndës vërtetohet se i akuzuari G.J. dhe të akuzuarit R.,B., dhe F.H. edhe para ditës kritike kanë pasur mosmarrëveshje, provokime nga ana e të akuzuarit G., duke e ofenduar dhe duke e sharë në nënë të akuzuarin R., në dyqani e tij dhe atë në prezencën e njerëzve tjerë, edhe më herët po nga ky i akuzuar është provokuar edhe i akuzuari B., për shkak të këtyre ofendimeve dhe provokimeve të bëra nga i akuzuari G. të akuzuarit R., B. dhe F. në ditën kritike në Viti në rrugën “...” e kanë sulmuar me shufra metalike të akuzuarin G... me ç’rast i shkaktojnë lëndime të lehtë trupore, lëndime këto që vërtetohen në ekspertizën e datës 17.04.2013 nga eksperti Dr. R.H. ortoped – traumatolog, kurse në këtë përleshje lëndime të rënda ka pësuar i akuzuari B.H., me ç’rast i akuzuari G.J. e godet me shufër metalike në para krahun e majtë i cili edhe pëson thyerje të kockës së radiusit e të cilat lëndime Dr. R.H. ekspert ligjor në ekspertizën e tij nr.656/2013 datë 18.04.2013 i ka kualifikuar si lëndime të rënda trupore të gjithë këto janë të vërtetuara edhe nga provat materiale, deklarata e të akuzuarve – dëmtuarve, dëshmitë e dëshmitarëve, raporti i policisë dhe foto dokumentacioni i cili gjinden në shkresat e lëndës.

Sa i përket bazës ankimore shkeljes së ligjit penal me ankesë i akuzuari G. thekson se nga konstatimi i gabuar ka ardhur edhe gjerë te aplikimi i gabuar i ligjit penal në dëm të këtij të akuzuari, ngase me dispozitën e neni 12 par. 1 të KPRK-së, thuhet se vepra e kryer në mbrojtje të nevojshme nuk është vepër penale, kurse sipas paragrafit 4 të njëjtës dispozitë thuhet se “kryerësi i cili i tejkalon kufijtë e mbrojtjes së nevojshme mund të dënohet më lehtë”, mirëpo gjykata këtë fare nuk e merr parasysh pra i akuzuari pretendon se vepra për të cilën ai është shpallur fajtor nuk përmban vepër penale, sepse i njëjti ka vepruar në mbrojtje të nevojshme, duke konsideruar se ai duhet të lirohet nga akuzua në bazë të nenit 364 par. 1 nën par. 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPPK-së, me pretendim se ekzistojnë elemente që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të tij.

Pretendimet se i akuzuari veprën penale e ka kryer në mbrojtje të nevojshme në momentin kur ishte i sulmuar nga ana e të akuzuarit B., e që në atë moment me të ishin edhe dy të akuzuarit tjerë R. dhe F. H. dhe se në rastin konkret kishte sulm në drejtim të tij kjo është vërtetuar edhe me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë pas administrimit të provave si dhe nga vet pohimi dhe prani i fajësisë nga ana e të akuzuarit B.. Pra, është vërtetuar se i akuzuari B. e kishte sulmuar në mënyrë të kundërligjshme dhe se ky sulm ka qenë i atëçastshëm dhe i drejtuar në drejtim të akuzuarit G., gjatë sulmit ndaj tij ishte përdorur shufra metalike, me çka i ka shkaktuar lëndim të lehtë trupor, por në momentin kur i akuzuar B. ndërpretë sulmin e lëshon shufrën metalike, e ky i akuzuar ishte drejtuar në drejtim të babil të tij R., në këtë moment i akuzuari G. e ka goditur të akuzuarin B. në dorë të cilën edhe ja then duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore fakt ky që vërtetohet, me këtë veprim i akuzuari G. kryen veprën penale për të cilën është shpallë fajtor, dhe atë në tejkalim (kapërcim) të mbrojtjes së nevojshme, e cila është e shprehur kur mbrojtja nuk është

proporcionale me sulmin, pasi që mbrojtja është ndërmarrë pasi ka pushuar sulmi ndaj tij, pra vepra penale është kryer duke kapërcyer mbrojtjen e nevojshme, për këtë arsye ligjvënësi ka paraparë dënim më të butë ose lirim nga dënim.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate gjykata e shkallës së parë drejtë ka aplikuar dispozitat ligjore kur të akuzuarit i ka shqiptuar dënimin me burg e të kushtëzuar, ngase i akuzuari këtë konflikt e ka provokuar dhe vet e ka sjell në gjendje të sulmit të kundërligjshme ngase më parë pa kurrfarë shkasi ka fyer – shajtur të akuzuarin R. në dyqanin – lokalin e tij, dhe se i njëjti provokimet i ka pasur edhe në drejtim të dy akuzuarve tjerë B. dhe F., rrethanë kjo e vërtetuar që mbështetet në dëshminë e dëshmitarit Sh.I., në deklaratat e dëshmitarëve – të akuzuarve R. dhe F. H., në foto dokumentacionin e lëndës, prandaj duke pasur parasysh të gjitha rrethanat e sipër përmendura del se është i drejtë konkludimi i gjykatës së shkallës së parë se në veprimet inkriminues të akuzuari G. janë përmbushur tipare e figurës së veprës penale lëndim i rëndë trupor, nga neni 189 par. 1 nën par. 1.1, 1.2 dhe 1.3 të KPRK-së lidhur me nenin 12 par. 4 të KPRK-së, të kryer në tejkalim të mbrojtjes së nevojshme. Pra, drejtë janë aplikuar dispozitat e kodit penal dhe se nuk ka shkelje të ligjit penal në dëm të akuzuarit siç pretendohet me ankesë.

Edhe pse aktgjykimi i shkallës së parë nuk ankimohet me ankesat e Prokurorit dhe atë të akuzuarit G., për shkak të vendimit mbi sanksionin penal, me gjithë atë kjo gjykatë konform nenit 396 të KPPK-së, aktgjykimin e ankimuar e shqyrtoj edhe në këtë aspekt dhe gjeti se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin G. pati parasysh sjelljen e tij korrekte në gjykatë, pendimin për veprën e kryer se është pajtuar me të akuzuarit tjerë, ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh lëndimin e shkartuar të akuzuarit B., si dhe provokimet e tij të bëra më herët dhe tejkalimin e mbrojtjes së nevojshme.

Vlerësimin e këtyre të rrethanave relevante për matjen e dënimit, e pranon edhe kjo gjykatë dhe gjen se në praninë e rrethanave të vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, nuk ka vend për shqiptimin e një dënimi më të butë se atë të cilin e ka shqiptuar gjykata e shkallës së parë me dënim burgu prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh, e të kushtëzuar në afat prej 18 (tetëmbëdhjetë) muajve. Mirëpo, kjo gjykata sipas detyrës zyrtare ndryshoj kohën e verifikimit të dënimit në 1 (një) vit, meqë sipas dispozitës së nenit 51 par. 2 të KPRK-së, me dënimin me kusht, gjykata i cakton kryerësit të veprës penale dënimin dhe në të njëjtën kohë urdhëron që ky dënim të mos ekzekutohet, nëse person i dënuar nuk kryen vepër tjetër penale për kohën e verifikimit të cilën e cakton gjykata. Koha e verifikimit nuk mund të jetë më e shkurtër se 1 vit dhe as më e gjatë se 5 vite, pra kjo kohë caktohet në vite të plota. Prandaj duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret si dhe rrethanat në të cilat është kryer vepra penale dënimin i shqiptuar të akuzuarit nga ana e gjykatës së shkallës së parë e i kushtëzuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi është në proporcion me shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo dëmtimit të vlerës së mbrojtur, me një dënim të tillë do të ndikohet që të parandalohet të akuzuarit nga kryerja e veprës penale në të ardhmen, do të bëjë rehabilitimin e tij, si dhe do t'i parandalohet personat tjerë nga kryerja e veprave penale, pra do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me dispozitën e nenit 41 të KPRK-së.

Edhe pse kundër aktgjykimit të ankimuar, të akuzuarit R.,B., dhe F.H., nuk kanë ushtruar ankesë e meqë arsyet për të cilat gjykata ka marrë vendim në dobi të akuzuarit G.J. i cili ka ushtruar ankesë për pjesën gjykuese të aktgjykimit, arsyet këto të cilat nuk janë personale dhe shkojnë edhe në dobi të këtyre të akuzuarve, aktgjykimi i ankimuar u ndryshua sa i përket vendimit për dënim – përkatësisht lidhur me kohëzgjatjen e kohës së verifikimit (kushtëzimit të dënimit) edhe përkitazi me këta të akuzuar nga 18 (tetëmbëdhjetë) muaj në 1 (një) vit, konform nenit 397 të KPPK-së, beneficium cohaesionis.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 403 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.796/2016 datë 29.11.2016

Bashk. Profesional
Hysni Ismaili

Kryetari i kolegjit
Rasim Rasimi

Anëtarët e kolegjit

Gani Zabeli
Biljana Rexhiq